

SHTOJCA 3

Formulari i kërkesës për vazhdimin e lejes mjedisore

Emri i kompanisë	“Haxha Company” Sh.p.k. Llaushë, Skenderaj
Lloji i veprimtarisë	Ekspluatim i gurit gëlqeror
Vendi/Lokacioni ku zhvillon Veprimtarinë	Terllabuç dhe Karaç, Vushtrri
Emri, mbiemri dhe nënshkrimi i personit përgjegjës i kompanisë	Haxhi Zejnullahi
Adresa	Llaushë, Skenderaj
Telefoni, fax, e-mail	044 214176 haxhakom@hotmail.com
Emri dhe mbiemri i personit kontaktues përgjegjës për mjedis	Sabri Shabani
Adresa	Mitrovicë
Telefoni, fax, e-mail	049 528787 haxhakompani@hotmail.com
Numri i vendimit të Lejes Mjedisore Paraprake	19/4105/ZSP/567/19, dt. 23.12.2019
Përshkrimi i dokumentacionit bashkangjitur kërkesës, përfshirë numrin e protokollit të dokumentit, datën e lëshimit dhe skadimit	• Certifikata e regjistrimit të Biznesit me nr. Unik Identifikues: 811014290, 05.02.2014; • Leja Mjedisore Nr.19/4105/ZSP/567/19, dt. 23.12.2019 • Licenca 1899/KPMM/2018, dt.04.01.2019, me këtë Licencë shfuqizohet Licenca me nr.1637/KPMM/2016 dhe Licenca me nr.1855/KPMM/2018; • Pëlqim Mjedisor Nr.18/2583/1-ZSP/183/18,dt. 22.06.2018; • Pëlqim Komunal, nr. prot. 08Nr.141/18, dt. 22.03.2018
Fatura e pagesës së tarifës për vazhdimin e Lejes Mjedisore	Po
Pesë (5) kopje fizike dhe një (1) elektronike (CD)	Po një (1) kopje fizike


Shtojca 2

Aplikacion për dhënien e lejes mjedisore

APLIKACION PËR DHËNJEN E LEJËS MJEDISORE		
1. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME		
1.1. Të dhënat për Operatorin		
1.1.1.	Emri i subjektit	“Haxha Company” Sh.p.k.
	Vendi	Llaushë, Skenderaj
	Adresa	Llaushë, Skenderaj
	Nr. i tel./fax	044 214176
	E-mail	haxhakom@hotmail.com
1.1.2.	Numri i regjistrimit të biznesit, data e regjistrimit	NUI811014290, 05.02.2014;
1.1.3.	Personi përgjegjës i kompanisë	Sabri Shabani
	Nr. i tel./fax	049 528787
	E-mail	haxhakompani@hotmail.com
1.2. Të dhënat për impiantin		
1.2.1.	Emri i impiantit	“Haxha Company” Sh.p.k.
1.2.2.	Adresa e lokacionit të impiantit	Terllabuç dhe Karaç, Vushtri


2. TË DHËNAT PËR LOKACIONIN E IMPIANTIT

2.1.	Të dhënat për lokacionin ku zhvillohet veprimtaria sipas hartës së bashkangjitur	“Haxha Company” Sh.p.k. Llaushë, Skenderaj Shfrytëzimi i gurit gëlqeror Terllabuç dhe Karaç, Vushtrri, aktivitetet minerare kryhen në pjesët e ngastrave kadastrale nr. P-70202065-00213-0, P-70202065-00748-0, numri i lëndës së Çertifikatës 18-1855/18 dhe 18-4962/16, në vendin e quajtur Ploça Zona kadastrale Tërllabuç dhe në pjesën e ngastrës kadastrale nr. P-70202036-00478-0, numri i lëndës së Çertifikatës 18-1855/18, në vendin e quajtur Vishe Velikog Puta, Zona kadastrale Karaçë, Komuna e Vushtrisë, në sipërfaqe prej 23552m². Ngastrat ne fjalë janë pasuri private ne emër të Kompanisë “Haxha Company” përpos ngastrat P-70202065-00213-0 që është pasuri private në emër të Hashim Alija të cilën Kompania „Haxha Company” e ka marr ne shfrytëzim. Ngastrat janë një sipërfaqe e terrenit me pjerrtësi të lehtë. Në afërsi të drejtpërdrejt të lokacionit ku planifikohet të shfrytëzohet guri gëlqeror dhe kryhen aktivitetet tjera minerare, nuk ka objekte banimi, objektet më të afërta të banimit janë në një largësi mbi 700m, prandaj s’është e nevojshme që të bëhen matjet detale sizmike të efekteve të cilat do të lajmërohen gjatë minimumit. Këto vlerësime shërbejnë si bazë për kuantifikimin e ndikimeve të mundshme dhe për përcaktimin e masave të nevojshme mbrojtëse duke marrë parasysh se kemi të bëjmë me një lëmi specifike për shfrytëzimin e gurit gëlqeror me ndikime kumulative të ndotjes. Ne bazë të rezervave të gurit gëlqeror dhe bazuar ne pozitën gjeografike të lokacionit që gjendet larg vendbanimeve, ne këtë lokacion ekzistojnë kushte të mira për shfrytëzimin e gurit gëlqeror. Sipërfaqja 23552m² e ngastrave kadastrale nr. P-70202065-00213-0, P-70202065-00748-0, dhe P-70202036-00478-0, në të cilat shfrytëzohet guri gëlqeror, është e përkufizuar me kufijtë dhe koordinatat në vijim:
------	--	--




Nr.		
Pik.	Y	X
1	7498719.086	4748486.158
2	7498724.374	4748500.085
3	7498770.744	4748531.141
4	7498867.423	4748558.087

5	7498904.804	4748562.675
6	7498930.602	4748560.321
7	7498955.400	4748517.959
8	7498968.690	4748496.439
9	7498981.497	4748482.574
10	7498976.961	4748374.548
11	7498922.717	4748341.707
12	7498798.173	4748399.180
13	7498708.866	4748464.519
14	7498764.645	4748471.894
15	7498787.672	4748497.330
16	7498882.767	4748513.547
17	7498899.393	4748510.047
18	7498907.740	4748508.071
19	7498903.221	4748493.624
20	7498900.121	4748446.445
21	7498927.909	4748416.183
22	7498941.549	4748401.792
23	7498945.639	4748394.132
24	7498915.976	4748376.493
25	7498814.586	4748424.389
26	7498807.273	4748413.157




2.2.	Numri kadastral i parcelës	Sipërfaqja 23552m ² e ngastrave kadastrale nr. P-70202065-00213-0, P-70202065-00748-0, dhe P-70202036-00478-0
------	----------------------------	--



2.3.	Përshkrimi i lokacionit të gjitha objektet dhe aktivitetet e tyre në atë zonë	Njëra nga veçoritë qenësore të hapësirës së analizuar, ‘‘Haxha Company’’ Sh.p.k. Llaushë, Skenderaj Shfrytëzimi i gurit gëlqeror Terllabuç dhe Karaç, Vushtri, në kuptim të përcaktimit të ndikimeve të mundshme në mjedis është edhe dendësia e popullatës dhe popullata. Këto fakte kuptimin e plotë të tyre e kanë para se gjithash për shkak të nevojës që të hulumtohen hollësisht ndikimet e mundshme negative në banorët që jetojnë në hapësirën e analizuar. Në komunën e Vushtrisë vlerësohet të ketë rreth 106.000 banorë, nga të cilët mbi 90% shqiptarë. Nën administrimin e Kuvendit Komunal të Vushtrisë janë të përfshira 67 fshatra, me një sipërfaqe prej 345 km² dhe dendësi të popullsisë 307banorë në një kilometër katror. Pjesa dërmuese e popullsisë që jetojnë nëpër fshatra merret me veprimtari bujqësore dhe blegtorale. Një pjesë e popullatës janë të punësuar në organizatat industriale ekzistuese të më hershme që janë ende duke funksionuar me kapacitet më të vogël, kurse një pjesë e konsideruar e popullatës është duke punuar në bizneset
------	---	--

		private që nuk janë të pakta e të cilat janë bartëse kryesore të zhvillimit ekonomik të komunës së Vushtrrisë. Në afërsi të drejtpërdrejt të lokacionit ku planifikohet të shfrytëzohet guri gëlqeror dhe kryhen aktivitetet tjera minerare, nuk ka objekte banimi, objektet më të afërta të banimit janë në një largësi mbi 700m, kështu që në pikëpamje mjedisore, duke pasur parasysh pozitën gjeografike të lokacionit ku do të bëhet shfrytëzimi i guri gëlqeror dhe aktivitetet tjera minerare, nuk do të ketë ndonjë ndikim relevant në popullatë, përpos që do të kenë vetëm dobi sepse një numër i popullatës do të punësohen për shfrytëzimin e gurit gëlqeror dhe kryerjen e aktivitetëve tjera minerare. Banorët e fshatrave përreth lokacionit kryesisht merren me bujqësi, pemëtarë dhe blegtori. Lokacioni për shfrytëzimin e gurit gëlqeror dhe kryerjen e aktivitetëve tjera minerare gjendet në anën e majtë të rrugës magjistrale Mitrovicë - Prishtinë, në distancë mbi 5km nga kjo rrugë, lokacioni gjendet në kilometrin e 11-të të magjistrals Mitrovicë-Prishtinë. Merret rruga për Gobujë dhe vazhdohet në rrugë të asfaltuar deri afër një kilometër para se të shkohet në fshatin Karaçë. Një kilometër para se të arrihet në fshatin Karaçë i qasemi rrugës së paasfaltuar në anën e majtë, me gjatësi rreth 1 km, me ç'rast na dërgon në lokacionin e planifikuar për shfrytëzimin e gurit gëlqeror. Rruga magjistrale Mitrovicë - Prishtinë e lidhë lokacionin ku planifikohet të shfrytëzohet guri gëlqeror dhe kryhen aktivitetet tjera minerare me të gjithë rrjetin rrugor të Kosovës.
2.4.	Të dhënat lidhur me florën dhe fauna në atë lokacion	Në bazë të shqyrtimeve vizuale në lokacionin ku shfrytëzohet guri gëlqeror ‘‘Haxha Company’’ Sh.p.k. Llaushë, Skenderaj, Shfrytëzimi i gurit gëlqeror Terllabuç dhe Karaç, Vushtrri, kemi hasur në bimësi që karakterizohet kryesisht nga bimët e ulta barishtore, manaferra, shkurre, si kaçuba, qarri, bungu, mal me rritje mesatare, etj. Këto bimë u përshtaten kushteve të jetës së tyre në shkëmbinjtë gëlqeror, në këtë hapësirë gjenden edhe kaçë, murrizi, mana, manaferra, etj. Pjesa e ngastrave në fjalë posaçërisht është e zhveshur diku diku e mbuluar me drunj të ultë në formë të kaçubave, pjesët e ngastrave ku do të shfrytëzohet guri gëlqeror, nuk përmbajnë vlera ekonomike në kuptimin e përdorimit si tokë bujqësore, por as edhe si zone me vlera kullosore. Bazuar në faunën ekzistuese dhe kushtet klimatike të rajonit të Terllabuçit dhe Karaçës, e duke marrë për bazë edhe të dhënat nga vendasit, në këtë zonë jetojnë gjitarët, zvarranikët, brejtësit, insektet e ndryshme, lepuri i egër, dhelpra, ujku, derri i egër, iriqi etj. Prej brejtësve jetojnë- mijtë, prej zvarranikëve- gjarpri i zakonshëm, bolla, breshkat e tokës zhapini i gjelbër, prej insekteve- insektet krahëfortë, krahëlusporë, mizat etj, ndërsa prej shpezëve janë karakteristike zogjtë, çafkat, bilbilat, thëllënëza e fushës, sorra, shqiponja, etj.
2.5.	Të dhënat mbi zonat e veçanta të mbrojtura	Në afërsi të lokacionit ku kryhen aktivitetet ‘‘Haxha Company’’ Sh.p.k. Llaushë, Skenderaj, Shfrytëzimi i gurit gëlqeror Terllabuç dhe Karaç, Vushtrri, nuk kemi zonat e veçanta të mbrojtura.

3. PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE MBI VEPRIMTARINË

3.1. Përshkrim i aktivitetit për të cilën kërkohet Leja Mjedisore		
3.1.1.	Skema e procesit teknologjik	Për të eksploatuar gurin gëlqeror “Haxha Company” Sh.p.k. Llaushë, Skenderaj, Shfrytëzimi i gurit gëlqeror Terllabuç dhe Karaç, Vushtrri, kryhen këto procese teknologjike si më poshtë: - Largimi i shtresës së dheut, shpimi – minimi, ngarkimi dhe transporti. Procesi i punës është ilustruar ne figurën animative si me poshtë:  Nuk kemi proces teknologjik ne këtë faze vetëm proces te punës: 1. Minimimi, 2. Mbushja ne kamion me ekskavator dhe 3. Dërgimi i gurit gëlqeror deri tek vendi për thërrmim
3.1.2.	Përshkrim i pajisjeve dhe fazat e procesit teknologjik	Për të shfrytëzuar gurin gëlqeror duhet të kryhen këto procese teknologjike: duhet bërë largimin e shtresës së dheut (sterilit), shpim, minim, ngarkim dhe transport. Për realizimin e procesit teknologjik për shfrytëzimin e gurit gëlqeror nevojiten këto pajime: Garnitura për shpim, një ekskavator, një bulduzher , një lopatë ngarkuese dhe dy deri tre kamionë special për bartjen e shkëmbit të minuar gjerë te gurthyesi me seperacion. Punimet e shfrytëzimit të gëlqerorëve në këtë vendburim do të zhvillohen sipas projektit kryesor të Xehetarisë ku janë përcaktuar të gjithë parametrat

tekniko-teknologjik për shfrytëzim. Në bazë të përvojës gjatë punës në kushte të njëjta dhe duke marrë për bazë karakteristikat e shkëmbinjve gëlqerorë në vendburim janë përcaktuar parametrat kryesor për hapje të karrierës: - lartësia e shkallëve do të jetë 10m. - gjerësia e sheshit të shkallës është 10-15m. - pjerrtësia punuese e shkallës është 70 gradë. - Shfrytëzimi i gurit gëlqeror do të kryhet përmes 5 shkallëve. - sterili dhe materiali humusor nëpër rrugë të projektuara do të bartët dhe deponohet ne deponin e caktuar enkas për të e pastaj do të deponohet në sipërfaqen e shfrytëzuar. - karakteristikat hidrogeologjike janë të volitshme nga aspekti i shfrytëzimit sepse ujërat atmosferike me punime minerare lehtë largohen nga karriera - hapja e karrierës bëhet duke u nisur nga kuota fillestare e vendburimit nga lartësia ne nivelin e kuotës 830m dhe nga thellësia ne nivelin e kuotës të shkallës 780m, me disnivel prej 50m. Ky proces bëhet në faza të cilat u cekën më lartë . Etazhet zhvillohen në drejtim veri- jug, dhe atë në një kat bëhet shpimi dhe përgatitja e fushës për minim , kurse në katin (etazhin) më lart bëhet ngarkimi dhe transporti i masës së minuar më herët . Minimi bëhet me eksplozive Amonali i përforcuar i cili është treguar efektiv në shfrytëzimin e gurit gëlqerorë. Për të pas një pasqyrë reale të lëndëve plasëse ne në këtë raport të VNM-s do ti japim karakteristikat teknike të Amonalit të përforcuar. Tipi i lendes plasëse 1. Amonium nitrat.....-82+1.5% 2. Trinitro trotuol.....- 14 + 1% 3. Tallash druri.....- 4 + 0.5% Karakteristikat <table> <tr> <td>Dendësia</td><td>kg/l</td><td>1.1-1.15</td></tr> <tr> <td>Shpejtësia e detonimit</td><td>m/s</td><td>4400-4500</td></tr> <tr> <td>Përcjellja e detonimit</td><td>cm</td><td>4-9</td></tr> </table>			Dendësia	kg/l	1.1-1.15	Shpejtësia e detonimit	m/s	4400-4500	Përcjellja e detonimit	cm	4-9
Dendësia	kg/l	1.1-1.15									
Shpejtësia e detonimit	m/s	4400-4500									
Përcjellja e detonimit	cm	4-9									

Bilanci i oksigjenit	% peshore	4
Vëllimi i gazrave	L/kg	+0.24
Lirimi i nxehtësisë	⁰ C	2564
Presioni i deponimit	Dn/m ²	56619
Diametri i llokumit	Ø	60

Në rastin e minimimit në gurin gëlqeror të Tërllabuçit dhe Karaçës, komuna e Vushtrrisë, është e kalkuluar largësia e hudhjes së copave shkëmbore, gjë që nuk paraqesin ndonjë rrezik për rrethinën. Konsumi specifik për një vrimë është llogaritur të jetë 30 kg e cila është 36 herë më e vogël se sasia e lejuar për shkallen e tretë të merkalit ku shpejtësia e lejuar e oscilimeve të trupit është 0.4 deri në 0.8 cm/s.

Por tani me sistemin e ri të minimimit, do të kemi sigurinë ma të madhe.

Nga kjo mundë të konstatojmë që veprimet sezmiologjike në objektet sipërfaqësore duke marrë parasysh distancën e larguar është i pranueshëm në procesin teknologjik. Rrezja e zonës së rrezikut caktohet në bazë të përdorimit të eksplozivit që aktivizohet:

$$R = 5 \sqrt{Q} = 5 \sqrt{2478} = 248,89 \approx 250 \text{ m'}$$

R- zona jo e rrezikuar për njerëz dhe objekte nga copat e hedhura të shkëmbit

Q- sasia e eksplozivit për një minim

5- koeficient i cili merret për distancën e palosjes së masës së shkëmbit (m)

Prandaj minimet ne këtë lokalitet nuk paraqesin ndonjë rrezik për rrethinën sepse objektet banuese janë të larguara nga lokacioni mbi 700m, kurse zona e rrezikuar për njerëz dhe objekte nga copat e hedhura të shkëmbit është $\approx 250\text{m}$.

Nga minimi gjithmonë duhet të ketë kujdes që madhësia e shkëmbit të minuar të jetë në granullometri të lejuar për fytyrën e thërrmueseve primare, gabaritet e mëdhenj nuk guxojnë të jenë prezent më tepër se 20% nga madhësia e fytyrës pranues.

3.1.3.	Numri i orëve të punës dhe ditëve të punës gjatë javës për kryerjen e aktiviteteve	8 ore x 6 dit 48 ore ne javë orari punës prej orës 08:00 deri 16:00.
3.1.4.	Kapaciteti i projektuar dhe kapaciteti i realizuar, ditor, mujor, vjetor	- Kapaciteti Ditor : Kapaciteti i projektuar - 640 m³/ditë, ai i realizuar 800 m³/ditë - Kapaciteti Mujor: Kapaciteti i projektuar – 12,800 m³/muaj, ai i realizuar 16,000.0 m³/muaj - Kapaciteti Vjetor: Kapaciteti i projektuar - 128,000.0 m³/vit gur gëlqeror i përpunuar, dhe ai i realizuar – 102,400.0 m³/vit
3.1.5.	Të dhënat për shfrytëzimin e lëndës së parë dhe lendeve ndihmëse.	Lënda e parë: • Guri Gëlqeror Lënda ndihmëse: • Nafta për makineri,
3.1.6.	Lista e rezervuarv e dhe kapaciteti i tyre	“Haxha Company” Sh.p.k. Llaushë, Skenderaj, Shfrytëzimi i gurit gëlqeror Terllabuç dhe Karaç, Vushtrri, nuk posedon rezervuar për deponimin e naftës
3.1.7.	Lista e legjislacionit në fuqi	Ligjet • Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 • Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060 • Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja Nr. 03/L-160 • Ligji për VNM Nr. 08/L181 • Ligji për mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102 • Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 02/L-41 • Ligji për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174 • Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110 • Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr.03/L-233 • Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147 Udhëzimet Administrative • Udhëzim Administrativ nr.04/2022 për Leje Mjedisore; • Udhëzim Administrativ(MMPHI) Nr.01_2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPHI–Nr.

		04/2022 për Leje Mjedisore; • Udhëzimi administrativ Nr.04 /2018 për Pengimin e aksidenteve të mëdha ku përfshihen substancat e rrezikshme; • Udhëzim administrativ (MMPHI) Nr. 1/2025 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore; • Udhëzim administrativ Nr.01/2017 për dhënien e Lejes Mjedisore Komunale; • Udhëzim administrativ nr.18 /2024 për formën, përmbajtjen dhe mënyrën e plotësimit të aplikacionit për leje mjedisore të integruar; • Udhëzimi administrativ (MMPHI) Nr.02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujor; • Udhëzim administrativ (QRK) Nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes.
--	--	--

3.2. Menaxhimi i Mbrojtjes së Mjedisit

3.2.1	Sistemi menaxhues i mbrojtjes së Mjedisit	Sistemi i menaxhimit mjedisor është instrumente që përcakton përgjegjësitë mjedisore për secilin anëtar apo punonjës të kompanisë, duke i ndihmuar ata të kuptojnë ndikimet mjedisore të shkaktuara nga aktivitetet apo veprimtaritë e tyre, si edhe të përcaktojnë objektivat mjedisore për të ulur ndikimet dhe për të përmirësuar performancën e tyre mjedisore. Sistemi i menaxhimit mjedisor paraqitet në formë të ndryshme dhe është ajo pjesë e sistemit të përgjithshëm të administrimit, që përfshin strukturën organizative, aktivitetet e planifikuara, përgjegjësitë, praktikën, procedurat dhe burimet për zhvillimin, zbatimin, arritjen, shqyrtimin dhe konsolidimin e praktikave mjedisore. “Haxha Company” Sh.p.k. Llaushë, Skenderaj, Shfrytëzimi i gurit gëlqeror Terllabuç dhe Karaç, Vushtrri, është e përkushtuar më të gjitha funksionet e saj organizative në përmirësimet e vazhdueshme që të përmbushë të gjitha detyrimet ligjore për të pasur një Mjedistë pastër dhe të qëndrueshëm. Sistemet e Menaxhimit Mjedisor bazuar në ISO 14001 japin mundësinë e identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të aspekteve mjedisore të një
-------	---	--

		organizate me synim: • Respektimin e legjislacionit vendor • Përmirësimin e komunikimit me autoritetet • Parandalimin e dëmtimit të Mjedisit • Përmirësimin e vazhdueshëm i Mjedisit
3.2.2	Raportimi	“Haxha Company” Sh.p.k. Llaushë, Skenderaj, Shfrytëzimi i gurit gëlqeror Terllabuç dhe Karaç, Vushtrri, ka kryer raportime sipas kushteve të Lejes Mjedisore Nr.19/4105/ZSP/567/19, dt. 23.12.2019
4. AJRI DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE		
4.1.	Pikat e burimit të emisioneve ematerieve ndotëse	Gjatë funksionimit kontinuel të Kompanisë ndotja e ajrit vjen nga qarkullimet e automjeteve transportuese të gurit gëlqerorë. Ndotje e mjedisit ndodh, gjatë procesit të transportit, pluhuri i cili emitohet në momentin e minimin të masës . Duke i marruar parasysh përqendrimet e ndotësve të cilat emitohen në lokacionin e kompleksit për eksploatim të gurit gëlqeror mund të përfundohet se ndotja e ajrit është me përmasa relativisht nën përqendrimet e lejuara dhe janë lehtë të kontrollohen. Gjatë realizimit të procesit teknologjik për eksploatim të gurit gëlqeror, ndikime negative në ajër ndodhin nga: - Pluhuri i cili lirohet gjatë fazës së minimin të cilin nuk është në përmasa të mëdha, - Pluhurat të cilët lirohen nga mekanizmi ngarkues i masës në kamionët transportues. - Pluhurat të cilët lirohen nga rrugët jo të asfaltuara dhe sipërfaqet operationale me zhavorr, - Ndotja e ajrit mund të ndodhë nga gazrat të cilët lirohen nga automjetet transportuese, që nevojiten për transportimin e masës së gurit gëlqeror deri tek përpunimi i tij, Gazrat të cilat lirohen nga automjetet e transportit dhe ngarkimit.
4.2.	Ndikimi i materieve ndotëse në cilësinë e ajrit	Ndikimi i emisionit të materieve ndotëse në kualitetin e ajrit varet para se gjithash nga kushtet klimatike –meteorologjike dhe numri i

		automjetet transportuese që transportojnë fraksionet të materialit. Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër, gjatë funksionimit të gurthyesit kompania ka marrë këto masa: - Spërkatja e rrugëve në temperatura të larta, - Përdorimi i makinerive të reja të cilat nuk lirojnë gazra të ndotura.
4.3.	Burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse	Burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse paraqiten nga pluhurat të cilët lirohen nga qarkullimi i automjetet brenda dhe jashtë kompleksit të gurthyesit. Pluhurat të cilët lirohen nga deponit të cilat nevojiten për deponimin e fraksioneve të agregatit, pluhurat të cilët lirohen nga shiritat transportues gjatë transportit të fraksioneve të agregatit lirimit të pluhurit nga sipërfaqet manipuluese.
4.4.	Pajisjet për trajtimin e gazrave shkarkuese	Nuk janë të nevojshme tek zona e eksploatimit,
4.5.	Pajisjet për de-pluhurim	Nuk janë të nevojshme tek zona e eksploatimit,
4.6.	Monitorimi i emisioneve	Kompania e bën monitorimi i emisioneve siç kërkohet në Leje Mjedisore.
4.7.	Monitorimi i Emisioneve /cilësisë së ajrit	Kompania "Haxha Company" Sh.p.k. Llaushë, Skenderaj, Shfrytëzimi i gurit gëlqeror Terllabuç dhe Karaç, Vushtrri, e bën kontrollin dhe matjet e emisioneve në ajër ashtu siç kërkohet
4.8.	Raportimet	"Haxha Company" Sh.p.k. Llaushë, Skenderaj, Shfrytëzimi i gurit gëlqeror Terllabuç dhe Karaç, Vushtrri, ka kryer raportime sipas kushteve të Lejes Mjedisore Nr.19/4105/ZSP/567/19, dt. 23.12.2019
4.9.	Masat për zvogëlimin e ndryshimeve klimatike	Për ta parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër të cilat i kemi cekur më lart, kompania ka marrë të gjitha masat duke - rrugët ku behet transportimi i masës shkëmbore vazhdimisht spërkatet me ujë. - Behet kontrollimi i rregullt teknik i makinave që konsumojnë lëndë të lëngëta djegëse me qëllim që emetimi i gazrave nga automjetet e punës të jetë sa më kualitativ. - E gjithë hapësira e kompleksit spërkatet me ujë posaçërisht në kohëra me erëra dhe temperatura të larta.

5.1.	Të dhënat për shfrytëzimin e ujit	Shfrytëzimi i ujerave behet nga pusi i hapur ne parcelën e kompanisë, uji përdoret për nevoja sanitare higjienike, për uljen e grimcave te pluhurit ne ajër si dhe për pastrimin e rrugëve.
5.2.	Të dhënat për shkarkimin e ujërave, shkarkimet e ujerave sipërfaqësore apo në rrjetin e kanalizimit	Shkarkimi i ujerave behet vetëm nga punëtorët edhe pse janë ne numër te vogël dhe sasia e ujit është e pa përfilleshe. Po ashtu kemi edhe shkarkimin e ujerave nga sipërfaqet akumuluese te cilat shkarkohen si pasoje e reshjeve atmosferike por këto ujera largohen ne mënyrë natyrore duke u infiltruar ne ujera nëntokësore.
5.3.	Ndikimet në ujë	Derdhja eventuale e derivateve si nafta, vajrat e ndryshme do të ndikojnë në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore.
5.4.	Emisionet e ujërave të ndotura - treguesi i emisioneve kryesor	Në kompaninë’’Haxha Company’’ Sh.p.k. Llaushë, Skenderaj, Shfrytëzimi i gurit gëlqeror Terllabuç dhe Karaç, Vushtrri,nuk gjeneron ndotje rrezik të ujërave sipërfaqësore, e pastaj edhe të ujërave nëntokësore, pasi qe ndërrimin e vajrave nuk e bënë brenda kompleksit por në autoservis andaj edhe nuk ka emisione të ujerave të ndotura.
5.5	Trajtimi i ujërave tëndotura	Në kompaninë’’Haxha Company’’ Sh.p.k. Llaushë, Skenderaj, Shfrytëzimi i gurit gëlqeror Terllabuç dhe Karaç, Vushtrri, nuk gjeneron ndotje rrezik të ujërave sipërfaqësore, e pastaj edhe të ujërave nëntokësore. Kompania nuk ka seperator për pastrimin e ujërave të grumbulluara nga sipërfaqet e lart cekura sepse nuk kemi vajra apo ujera te ndotura ne zonën e eksplotimit.
5.6.	Kontrolli dhe matjet	Nuk është e nevojshme te behet kontrolli dhe matjet e ujerave, vetëm ne rastet kur kërkohet dhe dyshohet për ndonje ndotje
5.7.	Raportimi	Nuk është i nevojshëm
5.8.	Leje Ujore për shfrytëzim të ujit	Nuk është e nevojshme, tek zonat e eksplotimit
5.9.	Leje Ujore për shkarkimin e ujërave	Nuk është e nevojshme,
5.10.	Masat për zvogëlimin e ndotjes së ujërave	Trajtimi i mbeturinave komunale mos te hidhen ne vende te pa caktuara dhe ndërrimi i vajit për makineritë duhet te behet ne servise adekuate

		dhe jo ne punishte.
--	--	---------------------

6. ZHURMA		
6.1.	Burimet	Në domenin e mbrojtjes së mjedisit zhurma paraqet një faktor me rëndësi hapësinore e cila ka ndikim të madh në dëmtimin e të dëgjuarit , në sistemin e nervor , në hipertension , në koncentrimin e njeriut në punë etj. Lokacioni ku është i vendosur’’Haxha Company’’ Sh.p.k. Llaushë, Skenderaj, Shfrytëzimi i gurit gëlqeror Terllabuç dhe Karaç, Vushtrri, është i ekspozuar zhurmës së krijuar nga faktorët e ndryshëm si: - Ekskavatorët ngarkues - Kamionët e transportit Por qe këto zhurma janë te pa perfillshme.
6.2.	Kontrolli dhe matjet	Si pasojë e lëvizjes së automjeteve, bagerave, autocisternave mundë të v’ie deri te ngritja e zhurmës ne përmasa te lejuara. Duhet të bëhen matjet e zhurmës në përputhje me ligjet dhe rregullat mbi mbrojtjen nga zhurma. Matjet duhet bërë në afërsi të objekteve të banimit. Për vlerësimin e rezultateve të fituara nga matjet duhet ti krahasojmë me vlerat e lejuara me standarde për vendet ku jetojnë dhe punojnë njerëzit.
6.3.	Raportimet	Raportimi i zhurmës do te behet sipas kushteve qe do te dalin nga leja mjedisore, do te behet matja dhe do te raportohet ne MMPHI.

7. TOKA		
7.1.	Ndikimet në tokë	Gjate fazës së, eksploatimit të gurit gëlqeror ne vendburimin e kompanisë, ndikim negative në tokë paraqitet në aspektin e degradimit të sipërfaqes së tokës, ndikim negative ne toke paraqitet nga mbeturinat e ngurta, prishja e peizazhit, ndotja e dheut është si pasoje e sedimentimit të ndotjeve që sjellën përmes ujërave

		sipërfaqësore që vine nga sipërfaqet e kompleksit të kompanisë për Eksploatimi i gurit gëlqeror dhe nga fundrrimet e komponentëve ndotëse nga ajri. Ndotja aksidentale e dheut e cila vije si pasoje e avarive të mëdha apo edhe të vogla
7.2.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë	Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në tokë Kompania ka marrë këto masa mbrojtëse: - Të gjitha mbeturinat e ngurta që nuk trajtohen më tutje si dhe mbeturinat e ngurta komunale grumbullohen dhe vendosen në kontejner të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim, me transport vetanak apo nëpërmjet ndërmarrjeve për menaxhimin e mbeturinave, këto mbeturina të dërgohen në deponint regjionale edhe pse shume pak krijohen tek zona e eksploatimit. Vaji, derivatet dhe fluidet tjera që i posedojnë automjetet (ekskavatorët, kamionët etj) nxirren në hapësirën e ndërtuar nga kompania ne zonën afër eksploatimit ku behet seperimi, thërrmimi i gurit gëlqeror por jo ne zonën e eksploatimit.
7.3.	Përshkrimi i rehabilitimit të zonëspas përfundimit të aktivitetit	Marrja e Masave Rehabilituese pas Përfundimit të Aktiviteteve të kompanisë "Haxha Company" Sh.p.k. Llaushë, Skenderaj, Shfrytëzimi i gurit gëlqeror Terllabuç dhe Karaç, Vushtrri, Objektivat e rikultivimit Trajtimi i rikultivimit në përputhje me kërkesat bashkohore të mbrojtjes dhe regjenerimit të mjedisit, duhet parë si një prioritet të rëndësishëm edhe në këtë regjion ku zhvillohet veprimtari minerare. Marrja e Masave Rehabilituese pas Përfundimit të Aktiviteteve të kompanisë për Eksploatimi të gurit gëlqeror Nga proceset teknologjike të, Eksploatimit të gurit gëlqeror do të krijohen substrate që i takojnë kategorisë së tokave të dëmtuara d.m.th. substrate të pa përshtatshme (sterile) për rikultivim. Substrate me përmbamës të areniteve, që pa tjetër duhet ti nënshtrohen rehabilitimit gjerë në masën e përmirësimit të pjesërishëm të vetive të tyre dhe krijimit ose zëvendësimit të tij me at të rrethit ashtu që të krijohet një substrat produktiv i përshtatshëm për rikultivim bujqësor

	dhe at malor. Rikultivimi i këtyre sipërfaqeve të dëmtuara përfshin rivitalizimin në tërësi të hapësirave të shfrytëzuara dhe dëmtuara nga punimet minerare. Zgjedhja e modelit të rikultivimit varet nga: Qëllimi i rekultivimit i cili nënkupton që pas përfundimit të punimeve minerale, sipërfaqeve të degraduara, prapë tu kthehet funksioni i saj primar (prodhimi i biomasës), dhe kështu zvogëlohet ndikimi negativ i këtij projekti në ekosistem. Planifikimi i shfrytëzimit të tokës– planifikohet që toka në lokalitet të mihjes të rikultivohet duke iu përshtatur gjendjes së përafërt me at të rrethit. Niveli i punimeve minerare - punimet minerare janë në fillim e sipër, rikultivimi është i lidhur me aktivitetet minerare, përkatësisht përfundimin e punëve dhe shpalljen e mihjes sipërfaqësore dhe gurthyesit të mbyllur. Të gjitha aktivitetet e lartshënuara synojnë objektivat e rikultivimit që kanë këto qëllime: • Prodhimi i biomasës - drurit. • Kthimin e profilit pedologjik të tokës së degraduar me rastin e punimeve minerare. • Pyllëzimi i sipërfaqeve të ç’veshura si pasojë e punimeve minerare. • Krijimin e një peizazhi të bukur, të përafërt me at të natyrës për rreth • Rehabilitimin e peizazhit dhe kthimin e pamjes vizuale në harmoni me formën relëfore të terrenit. • Zgjerimi i kapacitetit filtrues natyror të ajrit. Struktura përfundimtare e sipërfaqeve Struktura përfundimtare e sipërfaqes për rikultivim është e paraqitur në planin dhe projektin e rikultivimit. Pas përfundimit të punimeve minerare me rikultivimin teknik do të krijohet një profil i ri i tokës, e cila mund të përdoret edhe për nevoja tjera . Propozohet që rikultivimi të bahet me pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura dhe të pyllëzuara me bimë halore në pjesën e ngastrës ku bëhet eksploatimi I gurit gëlqeror. Për të qen rikultivimi sa më i suksesshëm duhet të
--	---

	kryhen këto faza të procesit të rikultivimit: Rikultivimi teknik, Rikultivimi agroteknik dhe Rikultivimi biologjik. Rikultivimi teknik Në bazë të ligjeve relevante të mjedisit çdo tokë e dëmtuar si shkas i aktiviteteve minerare, pas skadimit të afatit të shfrytëzimit ekonomik të karrierës, investitori është i obliguar që tokës ti kthej pamjen e më parëshme. Në bazë të punimeve të kryera hartografike- pedologjike në mihjen sipërfaqësore duhet konstatuar se cilët pjesë iu është nënshtruar dëmtimeve nga veprimet minerare, për këtë arsye duhet studiuar llojet e dëmtimeve si dhe intezitetin dhe ndikimin e tyre në botën bimore e pastaj të shqyrtohen mundësit e sanimit të efekteve të pavolitshme si dhe rikultivimi i kësaj pjese. Gjatë rikultivimit teknik duhet të përvetësohet teknologjia e tillë që rikultivimi të kryhet njëkohësisht gjatë punimeve në minierë, pra me teknologjinë mih – transporto – palos. Me krijimin e sipërfaqes së lirë nga sheshet punuese duhet të fillohet me dizajnimin teknik të hapësirës së lirë duke bërë përgatitjen e terrenit për rikultivim. Pas përfundimit të aktiviteteve minerare hapësira do të merr formën e degraduar e ndryshuar me peizazhin ekzistues, e cila me rastin e rikultivimit zonës i jep një pamje natyrale. Pas përfundimit të punimeve minerare fillon rikultivimi teknik i sipërfaqeve tokësore të degraduara. Degradimi i tokës gjatë punimeve minerare shkon deri në at masë sa bëhet zhdukja fizike e profilit pedologjik të tokës, prandaj për këtë fazë të rikultivimit propozojmë krijimin e profilit pedologjik të tokës në sipërfaqet e dëmtuara. Për formimin e shtresës së sipërme sipërfaqësore produktive të tokës parashihet mihja selektive e humusit dhe vendosja direkte në sipërfaqet punuese ku janë kryer punimet, d.m.th. duhet të përvetësohet teknologjia e tillë që rikultivimi teknik të kryhet njëkohësisht gjatë zhvillimit të punimeve në minierë. Pra me përfundimin e shfrytëzimit të vendburimit nga punimet e para minerare të lira, fillon shtresimi i dheut dhe humusit në këto shkallë. Nëse konstatojmë se shterpa nuk i plotëson kërkesat
--	--

kualitative për rikultivim kem cek edhe më parë, duhet të konsultohen ekspertët profesional të lëmisë së agronomisë dhe të sillet sasia e dheut nga një vend tjetër me qëllim të suksesit të rikultivimit.

Rikultivimi agroteknik


Pas fazës së rikultivimit teknik fillon faza e rikultivimit agroteknik e cila fazë starton me analizimin e substratit të krijuar, për të përcaktuar vetitë agrokimike dhe pedologjike. Në bazë të analizave të propozohen masat meliorative dhe agroteknike që do të aplikohen në këtë tokë të re. Eksploatimi I gurit gëlqeror me teknologjinë minerare dëmton mjedisin jetësor. Toka është njëri prej elementeve të këtij mjedisi të cilës përveç që i ndërrohet destinimi primar, pëson degradim të rënd, deri në zhdukjen fizike të profilit pedologjik të sajë. Kjo paraqet formën më të rënd të dëmtimit të tokave. Në rastin konkret kemi të bëjmë me një masiv të fort e cila është e mbuluar me tokë të cektë. Për të llogaritur numrin e fidanëve për tërë sipërfaqen që do të rikultivohet, duhet të kalkulohet me distancën në mes rendeve dhe distancën në rend.

$$Nf = S / a \times b$$

S - paraqet sipërfaqen, a – paraqet distancën në mes rendeve b – paraqet distancën në mes fidaneve. Në rastin tonë propozojmë që të dy këto distance të jenë nga 2 m. Në pjesët ku do të behët mbjellja e bimëve duhet të vendoset një shtresë e humusit prej 0,5m trashësi të analizuar nga aspekti agrokimik, pastaj duhet të bëhet ngjeshja e këtij substrati me qëllim që të jetë shtresa ma kompakte. Pas këtij operacioni duhet të bëhen vrimat në mënyrë të mekanizuar.

Thellësia e gropës duhet të jetë aq sa është i gjatë habitusi qendror i sistemit rrënjor të bimës, ndërsa gjerësia duhet të jetë e atillë që rrënjës t'i siguroj shtrirje sa më të lirë. Nëpër këto gropa duhet të hedhet 150 gr pleh mineral dhe pleh të djegur të shtallës e pastaj rreth bimës hidhet shtresa e dheut e cila duhet të jetë e ngjeshur sa më mirë. Të gjitha këto bimë duhet të kontrollohen me kujdes gjendja shëndetësore e fidaneve. Fidanët duhet të shoqërohen me ambullazh

	përkatëse ne momentin e blerjes. Nga sistemi rrënjor hiqen të gjitha pjesët e dëmtuara. Para se të mbillen fidanët, rrënjët e tyre duhet të zhyten në solucion prej bajgë të freskët dhe argjile me qëllim që kjo përzierje të shërbejë si ushqim fillestar për bimën, si dhe dheu të ngjitet sa më mirë për rrënje. Bima e përgatitur në këtë mënyrë është e gatshme për mbjellje. Koha më e përshtatshme për mbjelljen e kulturave shumëvjeçare është vjeshta. Gjatë dimrit rrënja është aktive si dhe posedon sasitë optimale të lagështisë, kështu ne pranverë bima ka një startim më të suksesshëm. Rikultivimi biologjik Qëllimi afatgjatë i rikultivimit biologjik është që të krijojmë ekosistem të ri në hapësirat e shfrytëzuara dhe të dëmtuara në të cilën do të krijohet baraspeshë relative e të gjitha elementeve të ekosistemit siç janë: toka, flora, fauna dhe efekti ekonomik në prodhimtarin bujqësorë, blegtorale dhe në silvikulturë. Rikultivimi biologjik është faza përfundimtare me të cilën arrihet edhe qëllimi i rikultivimit. Bimët të cilat i kemi propozuar në këtë projekt në sipërfaqet e mihjes sipërfaqësore është Pisha e zezë - Pinus tigr L. dhe Pisha e bardhë- Pinus silvestris L. Me kurorën e tyre pisha e zezë dhe e bardhë , i japin pamje të bukur peizazhit, janë bimë që i përgjigjen lartësisë mbidetare të cekura ne pasuset e më sipërme , si dhe janë bimë lehtë adaptuese dhe rezistuese ndaj dëmtuesve biologjik. Edhe pse janë propozuar këto bimë duhet të bëhet konsultimi me autoritetin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural . Mirëmbajtjes së plantacionit të krijuar duhet kushtuar kujdes i vaçant sidomos në ujitje, prashitje, krasitje etj. Pas mbjelljes së silvokulturave, pronari më tutje do të kujdeset për zhvillimin e tyre .
--	--



8. MENAXHIMI I MBETURINAVE

8.1. Përshkrimi i llojit të mbeturinave dhe klasifikimi sipas katalogut shtetëror të mbeturinave

Llojet e Mbeturinave janë:

Edhe pse janë në numër të vogël po i paraqesim mbeturinat të cilat herë pas herë mund të ndodhin në zonën e eksploatimit.

Mbeturina të ngurta komunale grumbullohen, klasifikohen dhe të vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim me qëllim të mbrojtjes së tokës dhe ujërave nëntokësor.

Mbeturina të ngurta komunale i grumbullohen dhe i vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim me qëllim të mbrojtjes së tokës dhe ujërave nëntokësor.

Për shkak se zona e eksploatimit është afër me zonën e thërrmimit dhe separimit atëherë mbeturinat vendosen në kontejner tek zona e thërrmimit dhe separimit.

Menaxhimin me vajrat mbeturinë duhet të grumbullohen dhe të vendosen në fuqi të mbyllura dhe të siguruara mirë. Klasifikimin dhe mënyrën e magazinimit të përkohshëm të mbeturinave e bënë në bazë të rregullave dhe kushteve të përcaktuara me Ligj të mbeturinave, Nr.04/L-060.

Sipas katalogut shtetëror kemi të bëjmë me mbeturina komunale siç janë:

		Mbeturina	Emri i mbeturinës	Shkalla rrezikshmërisë	Lloji i deponimit
		15 01 01	Letër	Jo të rrezikshme	Kontejner
		17 02 03	Plastika	Jo të rrezikshme	Kontejner për mbeturina
		15 01 01	Mbeturinat E ngurta komunale	Jo të rrezikshme	Kontejner për mbeturina
		20 01 01			
		20 01 08			
8.2.	Përshkrimi i Magazinimit apo deponimit të mbeturinave	Gjatë aktivitetit të Kompanisë për Eksploatim të gurit gëlqeror nuk bëhet magazinimin i përkohshëm të mbeturinave por mbeturinat e ngurta komunale grumbullohen, klasifikohen dhe vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim.			
8.3.	Përshkrimi për trajtim, përpunim dhe riciklimi të mbeturinave	Gjatë aktivitetit të Kompanisë nuk bëhet përpunim dhe riciklim i mbeturinave.			
8.4.	Dërgimi për trajtim dhe riciklim të operatori tjetër – kontrate me kompaninë me leje përkatëse	Mbeturina komunale deponohen në kontejner dhe pastaj bartën me kamionë privat nga kompania jone të cilat i dërgojmë në deponit regjionale për trajtim të mbeturinave.			
8.5.	Plani për menaxhimin e mbeturinave	Kompania "Haxha Company" Sh.p.k. Llaushë, Skenderaj, Shfrytëzimi i gurit gëlqeror Terllabuç dhe Karaç, Vushtrri, nuk ka hartuar Planin për menaxhimin me mbeturina.			
8.6.	Raportimi	Nuk bëhet raportimi			

9. RREZIKU NGA AKSIDENTET

9.1.	Plani për pengimine aksidenteve ne rast të rrezikut/plani i intervenimit të brendshëm dhe të jashtëm	Ne zonën e eksploatimit nuk është i nevojshëm plani për pengimin e aksidenteve aty mund te ndodh vetëm prishja apo djegia e makinerive ne rast te ndonjë defekte. Po ashtu rezervuar te naftës nuk ka ne zonën e eksploatimit.
9.2.	Përdorimi i substancave të rrezikshme kimike dhe preparateve, planifikimi i masavepër zëvendësimin e tyre	Kompania ''Haxha Company'' Sh.p.k. Llaushë, Skenderaj, Shfrytëzimi i gurit gëlqeror Terllabuç dhe Karaç, Vushtrri, nuk përdorë substanca të rrezikshme kimike dhe preparate.
9.3.	Masat për parandalimin e aksidenteve dhe zvogëlimi i pasojave	Për parandalimin e aksidenteve dhe zvogëlimi i pasojave Kompania ''Haxha Company'' Sh.p.k. Llaushë, Skenderaj, Shfrytëzimi i gurit gëlqeror Terllabuç dhe Karaç, Vushtrri, ka marre këto masa. • Bëhet përdorim i drejt, mbikëqyrja e rregullt dhe mirë mbajtje e pajisjeve. • E tërë sipërfaqja e kompleksit është e rrethuar me tel gjembor, • E tërë sipërfaqja e kompleksit është e rrethuar me tel gjembor dhe ku është nevoja edhe me mur statik. Në mënyrë permanente të mirëmbahet ambienti në kompleksin e kompanisë
9.4.	Raporti mbi gjendjen e sigurisë	Kompania ''Haxha Company'' Sh.p.k. Llaushë, Skenderaj, Shfrytëzimi i gurit gëlqeror Terllabuç dhe Karaç, Vushtrri, nuk posedon rezervuarin e naftës gjithashtu nuk përdor substanca te rrezikshme prandaj nuk e ka hartuar Raportin mbi gjendjen e sigurisë.

10. MASAT NË RASTET E PUNES JO STABILE TË IMPIANTIT

10.1.	Ndërprerja momentale e punës së impiantit	Nuk ka ndërprerja momentale të punës së impiantit
10.2.	Ndërprerja e punës	Ndërprerja e punës behet vetëm gjate sezonës së dimrit për arsye te temperaturave te ftohta.

11. NDIKIMI I MUNDSHËM I NDOTJES NË SHËNDETIN E NJERIUT

Ndikimi i mundshëm i ndotjes në shëndetin e njeriut:

Gjatë funksionimit kontinual të kompanisë ''Haxha Company'' Sh.p.k. Llaushë, Skenderaj, Shfrytëzimi i gurit gëlqeror Terllabuç dhe Karaç, Vushtrri, deri me tani nuk ka ndikuar negativisht në shëndetin e njeriut, veç sa ka pasur ndikim pozitiv në rrethin duke ju mundësuar që banoret të furnizohen me zhavorr të gurit gëlqeror me fraksione të ndryshme dhe cilësi të lartë të gurit. Ndikimi i mundshëm i ndotjes në shëndetin e njeriut është shumë i vogël, sepse pike se pari kompania është e kujdesshme dhe nuk bën ndotje në mjedis dhe e dyta shtëpitë janë larg lokacionit të kompanisë dhe deri me sot nuk kemi pas ndonjë aknes apo ndonjë dëmtim të shëndetit të njeriut.

Personi Përgjegjës për Mjedis

Emri Mbiemri: Sabri Shabani

Nënshkrimi

Personi përgjegjës i Kompanisë

Emri Mbiemri: Haxhi Zejnullahi

Nënshkrimi
